

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Filozofik / Departamenti i Punës Sociale
Titulli i lëndës:	Këshillimi psiko-social
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Semestri:	3
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Bujar Gallopeni, PhD
Detajet kontaktuese:	

Objektivat dhe përmbajtja:

Kjo lëndë është një prezantim hyrës mbi këshillimin psiko-social dhe është i dizajnuar që të pajisë studentët me një orientim në fushën e këshillimit. Lënda ka për qëllim që të ofroj studentëve studimin dhe diskutimin e teorive, strategjitë dhe konsideratat etike dhe ligjore që lidhen me këshillimin.

Kursi do të trajtojë konceptin e këshilltarit si agjent social për ndryshim dhe avokat për klientët, komunitetin, dhe profesionin e këshillimit. Megjithatë, qëllimi kryesor i lëndës është të pajisë studentët me mundësinë për të mësuar dhe praktikuar aftësitë themelore për të ndihmuar.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të mësimit:

Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët duhet:

1. Të kuptojnë faktorët historikë, politikë, socialë dhe filozofikë teorive të këshillimit.
2. Të kuptojnë teoritë bazë të këshillimit dhe si individë të rritet dhe të ndryshojë në një kontekst sistematik, si dhe vlerësimin kritik të teorive si.
3. Zhvillimi i një vetëdije më të lartë për karakteristika të tyre personale dhe besimet që ndikojnë në fushën e këshillimit dhe rolin e tyre të mundshëm si një këshilltar psiko-social.
4. Kanë një njohuri pune të etikës kodit dhe standardet e praktikës dhe të udhëzimeve themelore ligjore në këtë fushë.
5. Të ketë njohuri për çështjet e diversitetit, duke përfshirë botëkuptimet e ndryshme, racës / etninë, gjinia, klasa sociale, orientimit seksual, moshës, dhe gjendjes fizike dhe mendore.
6. Të jetë në gjendje të identifikojë karakteristikat e tyre që ndikojnë në procesin e të ndihmuarit dhe të jetë në gjendje për të identifikuar kompetencat themelore dhe aftësitë e nevojshme për të punuar me popullsi të ndryshme.
7. Zhvillimi i strategjive avokuese drejtuar drejt reduktimit të stigmës për çështjet psiko-sociale.
8. Kuptojnë rolin e mbikëqyrjes dhe parandalimin e ‘djegjes’ nga profesionistët.

Përmbajtja e lëndës:

Këshillimi Psikosocial – Konceptet dhe Qasjet

Kategoritë sociale dhe trajtimi psikosocial

Procesi i këshillimit psikosocial

Menaxhimi i rasteve në punën sociale

Qasjet e këshillimit psikosocial – teoritë dhe praktika

Këshillimi psikosocial me fëmijë

Këshillimi psikosocial me adoleshentë dhe të rinjë

Këshillimi psikosocial me familje

Këshillimi psikosocial – viktimat e dhunës në familje dhe trafikimi me njerëz

Këshillimi psikosocial me personat përdorim të substancave (narkotike, alkooli, etj)

Këshillimi psikosocial me të moshuarit

Qasjet në avokim për mbrojtje sociale të grupeve të marginalizuara/cenueshme.

Format e mësimdhënies dhe mësim nxënies:

- Ligjërata interaktive; Video; Mysafir ligjërues
- Aktivitete në grup ; Studim të rasteve
- Sesione nga studentët – studentët do të bëjnë sesione në formë të ushtrimeve me kolegët e tyre duke përdorur teoritë e ndryshme dhe do të reflektojmë mbi procesin.
- Reflektim nga studentët - studentët do të bëjnë disa detyra dhe shkruajnë disa materiale reflektues mbi ushtrimet që ata do të kryejnë duke përdorur qasje të ndryshme teorike të këshillimit psiko-këshillimor.

Mësimdhënësi shpjegon objektivat e mësimin studentëve përmes ligjëratave, përmes tabelës, projektorit dhe formave tjera vizuale prezantohen teoritë dhe konceptet kryesore. Mësimi i kombinuar interaktiv do të përdoret. Konkludime të përbashkëta do të nxirren përmes diskutimit të pyetjeve dhe çështjeve të ngritura.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

		%	Nota		Përshkrimi	Pikët	
Pjesëmarrja	në	10	10	(A)	Shkëlqyeshëm	91-100	
ligjërata							

Pjesëmarrja në ushtrime	10	9	(B)	Shumëmirë	81-90
Detyrat reflektuese	10	8	(C)	Mirë	71-80
Kolokvium I	30	7	(D)	Mjaftueshëm	61-70
Kolokvium II	40	6	(E)	Kaloi	51-60
<i>Total</i>	<i>100</i>	5	(F,FX)	Nuk kalon, kriteri i pamjaftueshëm	nën 51

Shpërndarja e fondit të orëve në raport me ECTS: 1 ECTS=25; 6 ECTS= 150 orë

45orë ligjërata; 30 ushtrime; 14 orë konsultime; 20 detyrat reflektuese dhe sesionet; 26 orë mësim individual; 15 orë përgatitjen për provim.

Mjetet e konkretizimit/ TI:

Tekste mësimore, artikuj, video, tabela, projektori, fletat e punës, materiale të përgatitura nga mësimdhënësi, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike te studimit:

Studentët duhet të bëjnë ushtrime me kolegë duke përdorur teknikën e luajtjes së roleve, reflektim në grup dhe individual në formë të detyrave si dhe improvizojnë seanca duke i inxhizuar dhe duke përdorur teoritë dhe konceptet që i trajtojmë në klasë. Këto detyrë ju mundësojnë studentëve të provojnë se si mund të jetë një seancë apo një takim këshillimi duke reflektuar pastaj mbi sfidat dhe mundësitë për përmisim. Gjatë semestrit studentët do të mësojnë mbi konceptet duke lexuar artikuj dhe punë në grup, ndërsa si pjesë e vlerësimit to të jenë dhe dy kolokviume (një në javën e 7-të dhe tjetra në javën e 14-të).

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Tamo A. (2005). *Këshillimi dhe psikoterapia/ Counselling and psycho-therapy*. Tiranë: ALBATROS – në gjuhën shqipe

Miller, W. R., & Rollnick, S. (2013). *Motivational interviewing: Helping people change* (3rd ed.). New York: Guilford Press.

Modulet per Mbrojtjen e Femijeve, Terre des Hommes, 2018.

Literatura shtesë që shfrytëzohet në lëndë:

Neukrug, E. S. (2012). *The world of the counselor: An introduction to the counseling profession* (4th ed). Belmont, CA: Cengage Learning.

Meier, S. T. & Davis, S. R. (2011). *The elements of counseling* (7th ed.). Belmont, CA: Brooks/Cole.

Martin, M. E. (2013). *Introduction to human services: Through the eyes of practice settings*. 3rd Edition. Boston, MA: Pearson.

Varianides, A. (2012). *The School Social Work Toolkit: Hands-On Counseling Activities and Workshops*. NSW Press

Corey, G. (2008). *Theory and Practice of Counseling and Psychotherapy*. Cengage Learning: UK

Corey, G., Corey, M. & Callanan, P. (2010). *Issues and ethics in the helping professions*. Monterey, Cal.: Wadsworth Publishing